

Akti i Themelimit

“Open Balkan Group ” Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

Sot, më datë 10/07/2023i nënshkruari:

- **Z. Orges Deraj, atësia Metlli, lindur më 28/04/1989** banues në rrugën **Mihal Grameno, pll 12, Ap. 56, Nj.A nr. 2 Tiranë**, me kombësi **Shqiptare**, mbajtës i kartës së identitetit me numër I90428111G

Me vullnetin tim të lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “(Ligj i Shoqërive) kam vendosur të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“Open Balkan Group ”** (Shoqëria) duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Emri dhe forma ligjore

Neni 1.

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë **“Open Balkan Group”** ndjekur në menyrë të pandashme nga shkurtimi “sh.p.k., cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Emri Tregtar i shoqërisë do të jetë **“Open Balkan Market”** ndjekur në menyrë të pandashme nga shkurtimi “sh.p.k., cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.3 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare“(Ligji i Shoqërive

Selia dhe kohëzgjatja

Neni 2.

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën **Rruga Mihal Grameno, pll. 12, Ap. 56, Nj.A 2, zk. 8180, nr. Pasurie 8/868+12-56 Tiranë**. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të vetëm

Objekti i veprimtarisë

Neni 3.

Shoqëria do të ketë si objekt kryesor:

- 3.1 Transformimi Digjital: Ofrimi i konsulencës dhe zhvillimi i projekteve për transformimin digjital të organizatave dhe bizneseve. Kjo përfshin identifikimin e mundësive të përmirësimit të performancës dhe efikasitetit përmes përdorimit të teknologjive digjitale, siç janë cloud computing, analiza e të dhënave, inteligjenca artificiale, robotika dhe automatizimi i proceseve.
- 3.2 Shoqëria jonë do të jetë e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve arkitekture, inxhinieri, ndertim, operim dhe mirëmbajtje të objekteve ndertimore dhe veprave infrastrukturore me funksione të ndryshme si dhe prodhimin, shitjen, blerjen e mallrave të ndryshme industrial, nga tregu i brendshëm dhe inport-export si dhe çdo aktivitet tjetër që duket i arsyeshëm dhe nuk bie në kundërshti me interesat e shoqërisë.
- 3.3 Zhvillimi, implementimi, dhe ofrimi i solucioneve të avancuara dhe inteligjente në industrinë e prodhimit. Kjo përfshin automatizimin e proceseve industriale, përdorimin e teknologjive të internetit të gjërave (IoT), analizën e të dhënave të prodhimit, dhe aplikimin e inteligjencës artificiale në përmirësimin e performancës së prodhimit.
- 3.4 Investimi në instrumente financiare (si titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj.), investimi në pasuri të paluajtshme dhe në asete (si të prekshme apo të paprekshme). Ky investim synon të krijojë vlerë ekonomike në pajtim me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të kontribuojë në përmirësimin e performancës së mjedisit dhe shoqërisë.
- 3.5 Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve smart: Krijimi, zhvillimi dhe ofrimi i produkteve dhe shërbimeve inovative që përdorin teknologjitë e avancuara dhe inteligjente. Kjo përfshin prodhimin dhe ofrimin e pajisjeve smart, aplikacioneve mobile, platformave online dhe solucioneve të tjera që ndihmojnë organizatat dhe individët të përmirësojnë përvojën e tyre dhe të jenë më efikasë në aktivitetet e tyre të përditshme.
- 3.6 Ofrimi i shërbimeve konsulence për shoqëritë e kontrolluara prej nesh dhe/ose për klientë të tretë, që përfshijnë konsulencën në fusha të ndryshme si financat, menaxhimi, ligjore, IT, zhvillimi i softuerëve etj. Këto shërbime synojnë të

ndihmojnë organizatat në avancimin e qëndrueshmërisë së tyre duke përdorur metodat dhe strategjitë e qëndrueshme në operacionet e tyre.

- 3.7 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në cdo kohë sic parashikohet në këtë Akt.

Kapitali Themeltar

Neni 4.

- 4.1. Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 10.000 (Dhjetë mijë) Lekë, i përbërë nga 1 kuotë, me një vlerë nominale 10.000 (Dhjetë mijë) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit.
- 4.2. Ortaku i vetëm themelues:
- **Z. Orges Deraj, atësia Metlli, lindur më 28/04/1989 banues në rrugën Mihal Grameno, pll 12, Ap. 56, Nj.A nr. 2 Tiranë, me kombësi Shqiptare, mbajtës i kartës së identitetit me numër I90428111G, zotërues i një kuote të barabartë me vlerë nominale 100%.**

Organet drejtuese dhe Administrimi

Neni 5.

- 5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:
- Asambleja e Përgjithshme e ortakëve
 - Administratori
- 5.2 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.
- 5.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë: **Z. Orges Deraj** i cili e merr këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejte rinovimi.

Dispozita Përfundimtare

Neni 6.

- 6.1 Cdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqëritë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i vetem i Shoqërisë, sot më datë 10/07/2023gjuhën shqipe në dy kopje.

**ORTAKU THEMELUES
ORGES DERAJ**